


# Eja, Më Ndiq – Veprimtaritë

Për mbrëmjen e shtëpisë ose studimin e shkrimeve të shenjta – ose thjesht për argëtim!



26 Shkurt – 3 Mars

## Tempujt prej Letre

PËR KAPITUJT TE 2 NEFI 11–19

Isaia dha mësim se tempujt janë vende të veçanta ku ne mësojmë rreth Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit (shih te 2 Nefi 12:3). Bëj tempullin tënd! Palose një copë letre në tre pjesë. Prite njërin skaj në formë trekëndore. Hape letrën dhe vizatoje veten në mes.

**Për fëmijët më të vegjël:** Shikoni së bashku një fotografi të tempullit. Flitni se si mund të ndieni dashuri në shtëpinë e Perëndisë njësoj si në shtëpinë tuaj.

4–10 Mars

## Dëshmi me anë të Këndimit

PËR KAPITUJT TE 2 NEFI 20–25

Isaia dha dëshminë e tij për Jezu Krishtin. Ai tha se Jezusi ishte forca e tij dhe kënga e tij (shih te 2 Nefi 22:2). Çfarë këngësh rreth Jezusit pëlqen ti? Flit rreth asaj se pse të pëlqejnë ato. Pastaj këndojini së bashku!

**Për fëmijët më të vegjël:** Këndoni së bashku këngën “Tregom’ Ngjarjet e Jezusit” (*Libri i Këngëve të Fëmijëve*, f. 36). Vëreni fëmijën tuaj që të ngrëjë lart një figurë të Jezusit sa herë që Ai përmendet te kënga.



28 Miku



11–17 Mars

## Koha e Tregimit të Historive – Rresht pas Rreshti

PËR KAPITUJT TE 2 NEFI 26–30

Ati Qiellor na ndihmon të mësojmë “rresht pas rreshti” ose pak e nga pak (2 Nefi 28:30). Së bashku, tregoni një histori të parapëlqyer nga shkrimet e shenjta rresht pas rreshti! Gjithsecili të thotë me radhë një fjali nga historia derisa historia të mbarojë.

**Për fëmijët më të vegjël:** Ati Qiellor na ndihmon të mësojmë rreth Jezu Krishtit. Shko te faqja 48 dhe ngjyrosni me radhë nga një pjesë të figurës.

ILLUSTRIMET NGA KATY DOORILL

18–24 Mars

## Hapat për të Ndjekur Jezusin

PËR KAPITUJT TE 2 NEFI 31–33

Nefi dha mësim se ne e ndjekim Jezu Krishtin kur kemi besim tek Ai, pendohe mi, pagëzohemi, e marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe durojmë deri në fund (shih te 2 Nefi 31). Shkruajeni secilin hap nëpër nga një copë të ndryshme letre, pastaj shpërndajini ato në dysheme. Një person i mbyll sytë dhe numëron deri në 10 ndërkohë që gjithë të tjerët qëndrojnë sipër një letre. Personi që numëroi, pastaj thotë njërin nga hapat për të ndjekur Jezusin. Personi në atë letër ka radhën për numërimin.

**Për fëmijët më të vegjël:**

Kur ne kemi besim te Jezu Krishti, ne e ndjekim atë që thotë Ai. Formoni një rresht dhe ecni përfaqë. Personi në fillim është udhëheqësi. Secili prej personave kopjon mënyrën se si ecën udhëheqësi. Bëjeni me radhë rolin e udhëheqësit!



25–31 Mars

## Zambakët e Pashkës

PËR PASHKËN

Për shkak të Jezu Krishtit, ne do të jetojmë sërish pasi të vdesim (shih tek Alma 40:22–25). Bëj punimin artistik me zambakët e Pashkës në faqen 17. Vëri zambakët aty ku mund t’i shohë familja jote për t’ju ndihmuar që ta kujtoni Shpëtimtarin këtë javë.

**Për fëmijët më të vegjël:** Lexoni për Pashkën në faqen 46. Vëreni fëmijën tuaj që të tregojnë me gisht secilën figurë të Jezusit teksa lexoni.

Mars 2024 29

